REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org. jedinice / Org. Unit: 02.1.a
Nr. Prot: 301/2
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. pages: -2-
Data / Datum / Date: 21/02/2023
Prishtinë/a

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-RepublicofKosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Datë: 21.02.2023**

Mbledhja e 130 e Qeverisë e Republikës së Kosovës mbahet më 22.02.2023, në orën 10:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

**RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 121 dhe 123 dhe ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet: 122 dhe 124 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizimin e Tregut për Produktet Bujqësore (MBPZhR)

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve buxhetore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për katërmbëdhjetë (14) projekte kapitale në përputhje me Marrëveshjet e Mirëkuptimit të nënshkruara nga Ministri i MZhR-së dhe Kryetarët e Komunave (MZhR)

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2022 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (ZKM)

5. Shqyrtimi i Draftit të Koncept-dokumentit për Faturat e Kulturave Bujqësore dhe Fletëmagazinave (MBPZhR)

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e strukturave për Hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit (ZKM)

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për Kartën për Komunën e Gjelbër dhe të Qëndrueshme (ZKM)

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MPB)

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin në parim të Kërkesës për huamarrje për Trepça Sh. A. (MFPT)

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për aprovimin e transfereve nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në tabelën 3.1 dhe 4.1 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40,000 € (dyzet mijë euro) (MFPT)

11. Informimi i Kabinetit Qeveritar mbi zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2022 (ZKM)

12. Të ndryshme